



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 28 shtator 2012
Nr. ref.:RK308/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

né

Rastin nr. KI62/12

Parashtruesi

Liridon Aliu

Kërkesë për interpretimin e Kushtetutës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović , Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almira Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

- Parashtrues i kérkesës është Liridon Aliu, kryetar i organizatës joqeveritare (OJQ) "Ngrite zérin dhe ti" (NZT), nga fshati Hajvali, Komuna e Prishtinës.

Objekti i çështjes

- Objekt i çështjes është interpretimi i një numri të madh të neneve të Kushtetutës, edhe pse parashtruesi i kérkesës nuk cek qartë se për cilat nene të Kushtetutës ka kérkuar interpretim, nga kérkesa mund të konkludohet se parashtruesi kérkon interpretimin e shumicës së normave kushtetuese.

Baza juridike

- Kérkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

- Më 28 qershor 2012, parashtruesi i kérkesës i parashtri kérkesën Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata). Njëkohësisht, parashtruesi kérkon edhe mbrojtjen e identitetit, pa cekur arsyet se pse e kérkon mbrojtjen e identitetit.
- Më 10 korrik 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kérkesës se kérkesa e tij është regjistruar në Gjykatë me numër KI-62-12.
- Më 20 shtator 2012, pas shqyrimit të raportit të Gjyqtarit rapportues Kadri Kryeziu, Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Prof.Dr. Enver Hasani, i rekomanduan gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmërinë e kérkesës. Gjithashtu Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës që të hedhë poshtë kérkesën për mbrojtje të identitetit si të pabazuar.

Përbledhja e fakteve

- Parashtruesi i kérkesës nuk i ka paraqitur Gjykatës fakte konkrete lidhur me kérkesën në fjalë, por udhëzon Gjykatën në një numër të madh të faqesh, dhe shpreh gatishmërinë të ndihmojë Gjykatën në gjetjen e këtyre fakteve.

Pretendimet e parashtruesit të kérkesës

- Parashtruesi i kérkesës kérkon interpretimin e Kushtetutës lidhur me sa vijon;
 - Detyrimet për pensionimin e personave të moshës 70 e më shumë vjeç,
 - Detyrimet e zyrtarëve publik dhe privat, të cilët janë nën akuzë penale, për të dhënë dorëheqje,
 - Zgjatjes së tepërt të procedurave para gjykatave,
 - Amnistia e personave recividist nga ana e gjykatës dhe Presidentit të Kosovës,
 - Mos-mbjatja e web faqeve nga ana e institucioneve publike,
 - Personat që kanë shumë vende të punës, prej 2-4,
 - Papërgjegjësia e medieve sa u përket kérkesave të OJQ-ve,
 - Çështja e dorëheqjeve të një numri të madh të zyrtarëve të lartë të Kosovës, për shkak të vjedhjeve të dëshmive nga stacioni policor në Pejë,
 - Të drejtën e OJQ-ve që të regjistrohen si institacione financiare dhe keqpërdorimi i donacioneve nga ana e OJQ-ve,
 - Moszbatimi i ligjit, dhe jo transparenca me rastin e nxjerrjes së tyre,
 - Dhe një varg çështjesh tjera që nuk mund të specifikohen saktësisht.

9. Parashtruesi i kérkesës kérkon nga Gjykata Kushtetuese të Kosovës si vijon:

“Kérkojmë nga Gjykata Kushtetuese të analizojë mirë kérkesën tonë për interpretim kushtetues. Aty në linqe mund të gjeni raste të shumta si zotëri Mujë Rugova, i cili ka mbushur 70-71 vite - është dashtë të jetë në pension po ende punon – kësi rastesh në linqet që i kemi cekur në kérkesën tonë mund të gjeni mjaft, etj.”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kérkesës

10. Kriteret e pranueshmërisë janë paraparë me Kushtetutë, në detaje të specifikuara me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.

11. Nenet 113.1, 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës parashohin kornizën ligjore të kritereve për pranueshmërinë e kérkesës së individit dhe personit juridik, ku thuhet:

„113. 1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. (...)

113.7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

21. 4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”

12. Në rastin konkret, parashtruesi i kérkesës ka kérkuar interpretimin e një numri të madh të normave kushtetuese për të mirën e të gjithë qytetarëve të Kosovës, gjë që tregon se parashtruesi i kérkesës kérkon interpretim abstrakt të Kushtetutës. Në qoftë se parashtruesi i kérkesës synonte një gjë të tillë, person juridik, atëherë ai nuk mund të konsiderohet si palë e autorizuar.

13. Në të vërtetë, parashtruesi i kérkesës nuk konteston asnjë vendim të organeve publike, çfarë do t'i mundësonë të jetë palë e autorizuar në procedurën në Gjykatë, siç edhe parashihet me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, si bazë juridike për parashtrimin e kérkesës së tij. Përveç kësaj, parashtruesi i kérkesës nuk ka paraqitur argumente që do të provonin se ai është viktimi e drejtpërdrejtë e interpretimit të gabuar të dispozitave ligjore, interpretimin e të cilave e kérkon.

14. Vetëm individët, siç edhe parashihet shprehimisht me nenin 113.2 deri 113.6 të Kushtetutës, janë palë e autorizuar t'i parashtrojnë Gjykatës çështjet e vlerësimit abstrakt të kushtetutshmërisë.

15. Për më tepër, sistemi kushtetues-juridik i Kosovës nuk parasgeh „*actio popularis*“, që është modalitet i ankesave individuale që i mundësojnë cilitdo individ, i cili tenton të mbrojë interesin publik dhe rendin kushtetues, që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese lidhur me shkeljet e tillë, edhe pse nuk e ka statusin e viktimës.

16. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kérkesës nuk është palë e autorizuar për të kérkuar interpretimin e normave kushtetuese në abstrakt, shih për këtë, kjo kérkesë duhet shpallë e papranueshme. Gjithashtu Gjykata vlerëson se kérkesa për mbrojtjen e identitetit është e pabazuar.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenit 46, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1a) dhe 36 (3c), të rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 20 shtator 2012, njëzëri

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportuese



Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani